



DEKLARATË PRIVATËSIE

PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE LIDHUR ME AKTIVITETET E PROGRAMIT PËR KOMUNIKIM DHE NDËRGJEGJËSIM TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

Përmbajtja

1. HYRJE.....	1
2. QËLLIMET E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE	1
3. TË DHËNAT QË PËRPUNOHEN.....	2
4. AUTORITETI PËRGJEGJËS PËR PROCESIN E PËRPUNIMIT	2
5. MARRËSIT E TË DHËNAVE	2
6. DISPONUESHMËRIA E TË DHËNAVE, QASJA NË TO DHE KORRIGJIMI I TYRE.....	3
7. ARSYEJA PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE.....	3
8. AFATET E MBAJTJES SË TË DHËNAVE	3
9. KONTAKTI.....	3
10. ANKESAT.....	3

1. HYRJE

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) u përmbahen standardeve më të larta në mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave personale. Në pajtim me nenin 34(11) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, punonjësi për mbrojtjen e të dhënave i DHSK-së udhëhiqet nga standardet e BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo deklaratë për privatësinë ju tregon se çfarë mund të prisni kur DHSK-ja mbledh të dhëna personale dhe vlen për të dhënat që ne mbledhim lidhur me aktivitetet e Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së, deklarata shtypi ose për regjistrime për marrjen e buletineve të lajmeve dhe për përdorimin e këtyre të dhënave në publikimet e veta dhe veprimtaritë e tjera mediatike (përfshirë Internetin), për prezantimin e mandatit dhe aktiviteve të DHSK-së.

2. QËLLIMET E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE

Qëllimi parësor i përpunimit të të dhënave është informimi i publikut për mandatin dhe aktivitetet e DHSK-së me anë të informimit publik dhe aktiviteve të komunikimit dhe ndërgjegjësimit. Ndër qëllimet e tjera mund të përfshihet edhe bashkërendimi i këtyre aktiviteve.

3. TË DHËNAT QË PËRPUNOHEN

Përdoren vetëm të dhënat e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të lartpërmendura. Të dhënat personale që mund të përpunohen për këto qëllime janë si më poshtë:

- emri;
- mosha;
- të dhënat e kontaktit;
- numri i pasaportës;
- pyetja ose pyetjet tuaja
- profesioni ose fusha që studioni
- nënshkrimi juaj në formularin e dhënies së pëlqimit ose formularin e autorizimit të përdorimit të të dhënave;
- fotografi, videoincizime ose audioincizime tuaja që keni dhënë me shkrim.

Për të mbrojtur sigurinë e të dhënave personale dhe për të parandaluar qasjen, ndryshimin, fshirjen dhe nxjerrjen e paautorizuar të të dhënave, zbatohen masa të përshtatshme organizative dhe teknike.

4. AUTORITETI PËRGJEGJËS PËR PROCESIN E PËRPUNIMIT

Autoriteti përgjegjës që përcakton qëllimin dhe mjetet e procesit të përpunimit të të dhënave është DHSK-ja.

5. MARRËSIT E TË DHËNAVE

Marrës të të dhënave tuaja personale mund të jenë:

- punonjës të caktuar të Njesisë për Informim dhe Komunikim me Publikun (NJKP);
- punonjës të tjerë të autorizuar të DHSK-së;
- partnerë dhe kontraktues të autorizuar të NJKP-së të cilët koordinojnë përzgjedhjen dhe përgatitjen e videomaterialit, planifikimin e aktiviteteve, konkurseve për ese dhe aktivitete të tjera për komunikim dhe ndërgjegjësim;
- auditues të brendshëm dhe të jashtëm.

Për fushata konkrete, pyetjet lidhur me komunikimin dhe ndërgjegjësimin mund të redaktohen dhe t'i shpërndahen publikut pa përmendur autorësinë, përmes mediave digjitale, transmetuese ose të shtypit. Edhe fotografitë, videoincizimet ose audioincizimet tuaja që keni dhënë, mund t'i shpërndahen publikut përmes mediave digjitale, transmetuese ose të shtypit.

Përdorimi i mediave sociale

DHSK-ja i përdor mediat sociale për publikimin e përmbajtjes dhe për t'i dhënë informacion publikut në kontekst të aktiviteteve për komunikim dhe ndërgjegjësim. Krahas faqes në Internet të DHSK-së, videomaterialet mund të nxirren në kanalin e DHSK-së në *YouTube* ([KSC YouTube channel](#)) si dhe përmbajtja mund të paraqitet në *Twitter*. Përdorimi i mediave sociale në asnjë mënyrë nuk nënkupton mbështetjen e tyre ose të politikës së tyre të privatësisë. Rekomandojmë të lexoni politikën e privatësisë të [Twitter](#) dhe [YouTube](#) në të cilin shpjegohet politika e përpunimit të përdorimit të të dhënave, të drejtat e përdoruesit dhe mënyra se si përdoruesit mund të ruajnë privatësinë e tyre gjatë përdorimit të këtyre shërbimeve.

6. DISPONUESHMËRIA E TË DHËNAVE, QASJA NË TO DHE KORRIGJIMI I TYRE

Keni të drejtë të kërkonit qasje në të dhënat tuaja personale, si dhe të kërkonit korrigjimin e të dhënave personale të pasakta ose paplota; keni të drejtë të kërkonit fshirjen e të dhënave tuaja personale nëse DHSK-ja nuk ka arsye për mbajtjen e tyre.

7. ARSYEJA PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Kur regjistroheni për marrjen e buletineve të lajmeve dhe/ose deklaratave për shtyp të DHSK-së përmes postës elektronike, ne do të përdorim adresën e elektronike që na jepet prej jush për aq kohë sa kemi pëlqimin tuaj. Varësisht prej aktivitetit ose fushatës konkrete të komunikimit dhe ndërgjegjësimit, arsyeja e përpunimit të të dhënave tuaja bazohet në dhënien e pëlqimit me shkrim dhe formularin për autorizimin e përdorimit të tyre, ose sepse është e nevojshme për kryerjen e një detyre me interes publik, ose për ushtrimin e kompetencave zyrtare që i janë ngarkuar autoritetit përgjegjës.

8. AFATET E MBAJTJES SË TË DHËNAVE

Të dhënat ruhen për një kohë të kufizuar në përputhje me afatet e mbajtjes së Aseteve të Informacionit të DHSK-së.

9. KONTAKTI

Nëse keni pyetje në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale, ju lutemi kontaktoni punonjësin për mbrojtjen e të dhënave në adresën elektronike dataprotection@scp-ks.org.

10. ANKESAT

Pas marrjes së përgjigjes nga punonjësi për mbrojtjen e të dhënave, keni të drejtën e ankimit në çdo kohë, duke iu drejtuar këshilltarit ligjor në kabinetin e Administratores, në adresën elektronike LegalCounsel@scp-ks.org.